

**Njoftim për përqendrim me të cilin Shoqëria Aksionare "Telekom Srbija" Beograd,
Republika e Serbisë do të fitojë kontroll mbi NDËRMARRJEN PËR
TELEKOMUNIKIME ALTEKO SHPK PETROVAC**

(Lënda nr. 08-160 /2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 14.11.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin Shoqëria Aksionare "Telekom Srbija" Beograd, me seli të regjistruar në rrugën "Takovska" numër 2, Beograd, Republika e Serbisë, do të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë individual mbi NDËRMARRJEN PËR TELEKOMUNIKIME ALTEKO SHPK PETROVAC, me seli në 8 Tetori 22, 12300 Petrovac na Mlavi ("Shoqëria e synuar").

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste

Telekom Srbija SHA është operator për shërbime dhe rrjete të komunikimit elektronik, i regjistruar për telekomunikime kabllore, dhe mes tjerash ofron shërbime për telefoni fikse dhe celulare, internet dhe shërbime multimediale në territorin e Republikës së Serbisë.

NDËRMARRJA PËR TELEKOMUNIKIME ALTEKO SHPK PETROVAC është operator për shërbime dhe rrjete të komunikimit elektronik, në momentin e parashtrimit të Njoftimit, e regjistruar për ofrimin e qasjes në internet dhe shërbimeve të internetit, shpërndarje të përmbajtjes mediatike.

NDËRMARRJA PËR TELEKOMUNIKIME ALTEKO SHPK PETROVAC nuk ka persona juridikë të lidhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, as nuk ka realizuar të ardhura në atë territor.

Person i lidhur i Telekom Srbija SHA në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut është Shoqëria për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup, selia e së cilës është e regjistruar në rrugën "Maksim Gorki" 11/1-3, Shkup, Qendër, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e regjistruar për veprimtarinë telekomunikime me tela, respektivisht për ofrimin e shërbimeve vijuese: rrjet publik radio-komunikues, qasje në internet me brez të gjerë, shërbime ndër operatorësh, satelit etj.

Person i lidhur i MTEL SHPKNJP Shkup është Shoqëria për telekomunikime MTELMOBILE SHPKNJP Shkup. Shoqëria për telekomunikime MTELMOBILE SHPKNJP Shkup punon në tregun për ofrimin e shërbimeve celulare të komunikimit elektronik (shërbimi me parapagesë/prepaid) dhe nuk u ofron shfrytëzuesve të saj përfundimtarë shërbim celular postpaid. Shoqëria për telekomunikime MTELMOBILE SHPKNJP Shkup është operator i rrjetit celular virtual (ORRCV) në tregun maqedonas për komunikime elektronike dhe ofron shërbime zanore kombëtare, ndërkombëtare dhe roaming, SMS dhe internet.

Gjithashtu, person i lidhur i Telekom Srbija SHA në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut është Shoqëria për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup, me seli në Bulevardin Partizanski Odredi nr. 17, 1-001/Shkup-Qendër, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e regjistruar për veprimtarinë telekomunikime satelitore.

Për qëllimet e vlerësimit të këtij përqendrimi parashtruesi i njoftimit propozon që si treg përkatës të përkufizohet tregu për ofrimin e shërbimeve të qasjes fikse në internet me brez të gjerë dhe tregu për ofrimin e shërbimeve të shpërndarjes së përmbajtjes mediatike.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose përmes e-mailit: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision në afat prej 10 ditëve nga dita e shpalljes së këtij njoftimi.

20.11.2025

Shkup